



Nr. 1045/Prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI POLITEKNIK I TIRANËS
SENATI AKADEMIK

Tiranë, më 17/04 /2025

V E N D I M

Nr. 13, datë 17.04.2025

P Ë R

**MIRATIMIN E PROJEKTEVE KËRKIMORE-SHKENCORE, PROPOZUAR PËR
PROGRAMIN E STUDIMIT TË CIKLIT TË TRETË “DOKTORATË” NË INXHINIERI
MEKANIKE, ME NËNFUSHA INXHINIERI MEKANIKE DHE NËNFUSHA INXHINIERI
E MATERIALEVE, TË RIORGANIZUAR, NË FAKULTETIN E INXHINIERISË
MEKANIKE, NË UNIVERSITETIN POLITEKNIK TË TIRANËS, PËR VITIN
AKADEMIK 2025-2026**

Mbështetur në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", Vendimin Nr. 41, datë 24.01.2018, "Elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë", i ndryshuar, Udhëzimit të MAS Nr. 1, datë 14.01.2020 "Për dokumentacionin dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të Arsimit të Lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e Institucionit të Arsimit të Lartë" i ndryshuar, VKM 112, datë 23.02.2018, e ndryshuar, Urdhërit të MAS Nr. 383, datë 25.07.2024, Rregulloren e Studimeve të Doktoratës të UPT-së dhe kërkesën e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike, Senati Akademik në mbledhjen e datës 17.04.2025,

VENDOSI:

Të miratojë projektet kërkimore shkencore me titull:

1. Hartimi i një platforme dixhitale për optimizimin e të gjitha proceseve në industrinë e veshjeve dhe këpucëve në Shqipëri. Rekomandime mbi përzgjedhjen e sistemeve dhe teknologjive për optimizimin e proceseve që duhet të përdorin kompanitë në vend;
2. Përfitimi i lëkurëve inovative, përcjellëse të elektricitetit, për prodhimin e produkteve të zgjuara, dhe studimi i vetive fiziko-mekanike dhe kimike për përshtatshmërinë në këto produkte;
3. Matja e performancës së zinxhirit të furnizimit në proceset e prodhimit nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së Big Data;
4. Ndikimi i politikave të reduktimit të emetimeve karbonike në strategjitë e Marketingut në Industri;
5. Implementimi i Inteligjencës Artificiale (IA) në bizneset shqiptare dhe ndikimi në kënaqësinë e konsumatorëve;
6. Teknologjitë e dixhitalizimit për një industri të qëndrueshme;
7. Përmirësimi i planifikimit të prodhimit nëpërmjet dixhitalizimit dhe Industria 5.0;

8. Optimizimi i Performancës së Barrierave Mbrojtëse Rrugore: Analizë Strukturore, Tribologjike dhe e Deformime Kufitare;
9. Studimi i Ndikimit të Vibrimeve në Strukturën e Automjeteve dhe Optimizimi i Izolimit Akustik të Barrierave Rrugore;
10. Implementimi i turbinave vertikale në infrastrukturën e transportit rrugor;
11. Projektimi mekanik i sistemeve hekurudhore të ndërtuara me materiale të ricikluara eko-miqësore për transport të qëndrueshëm;
12. Ndikimi i modeleve të menaxhimit të riskut në zhvillimin e politikave strategjike në sektorin e prodhimit.

Propozuar për programin e studimit të ciklit të tretë “Doktoratë” në Inxhinieri Mekanike, me nënfusha Inxhinieri Mekanike dhe nënfusha Inxhinieri e Materialeve, të riorganizuar, në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, në Universitetin Politeknik të Tiranës, për vitin akademik 2025-2026.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Prof. Dr. Akli Fundo

